



**PROGRAM ORIENTUES
PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR
“MËSUES PËR SHQIPËRINË”
2024**

**PËR
ARSIMIN SPECIAL**



TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE.....	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR.....	4
FUSHA: PROGRAME LËNDORE.....	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE- NXËNIE.....	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT.....	9
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE.....	9
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS.....	10



HYRJJE

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” në arsimin special është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit të arsimit special. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MAS-i ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- a) Dokumente zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve.
- b) Programe lëndore.
- c) Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi, si dhe të arsimit special në veçanti.
- d) Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- e) Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- f) Përmbajtja shkencore e kurrikulës së arsimit special.

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” në arsimin special është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të kandidatëve.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e aftësive profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësisive shkencore të arsimit special, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të arsimit special është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i arsimit special që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesinqë të identifikojë nevojat e tij, si dhe për çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, **për secilën fushë prezantohen kompetencat** që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR

Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit special:</i> <ul style="list-style-type: none">- zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi;- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.- Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.- Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e

<ul style="list-style-type: none"> - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<p>punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. -Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet publike në arsimin parauniversitar”.
---	---

FUSHA: PROGRAME LËNDORE

<p style="text-align: center;">Kompetenca</p> <p style="text-align: center;">“Përshtatja në mënyrë efektive i programeve në lidhje me specifikat e fëmijëve në arsimin special”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton dhe përshtat programet në lidhje me specifikat e fëmijëve në arsimin special; - përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të fëmijëve në arsimin special; - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar zhvillimin e aftësive të fëmijëve në arsimin special; - harton programet edukative individuale PEI në përputhje me specifikat e fëmijëve në arsimin special. 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza Kurrikulare, 2014. - Kurrikula bërthamë AMU, klasat 6-9, 2014. - Programet aktuale lëndore të arsimit fillor. - Literaturë që ka në fokus sindroma të ndryshme si autizëm, down, prapambetje mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj.

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

<p>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme për mësimdhënien në arsimin special”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në programin PEI; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e secilës fushë të zhvillimit të fëmijës. - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për fëmijën; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të fëmijës. 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. https://www.ascap.edu.al/korniza-e-vleresimit-te-nxenesit-ne-arsimin-parauniversitar/ - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017. https://www.ascap.edu.al/udhezues-per-amu-2017/ - “Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, - për mësuesit ndihmës në arsimin parauniversitar”, ASCAP 2020. https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2021/02/Manuali-per-mesuesit-ndihmes.pdf - Literaturë që ka në fokus sindroma të ndryshme si autizëm, down, prapambetje mendore, çrregullime te sjelljes, hiperaktivitet etj.. - Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë planifikimin, organizimin e orës së mësimit dhe vlerësimin në arsimin special.

--	--

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca “Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, fëmijët, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, fëmijët, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në 	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

institucionin arsimor.	
------------------------	--

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënie në arsimin special”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe shpjegon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon kurrikula në arsimin special; - dallon karakteristikat e fëmijëve për secilën fushë të zhvillimit të tyre; - dallon karakteristikat e fëmijëve sipas llojeve të aftësisë së kufizuar; - tregon aktivitetet kryesore që dallojnë fëmijët në arsimin special sipas llojeve të aftësisë së kufizuar; - dallon modelet e ndërhyrjeve të efektshme të fëmijët me aftësi të kufizuar. 	<ul style="list-style-type: none"> - “Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, - për mësuesit ndihmës në arsimin parauniversitar”, ASCAP 2020. https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2021/02/Manuali-per-mesuesit-ndihmes.pdf - Literaturë që ka në fokus njohuri dhe informacion rreth arsimit gjithëpërfshirës dhe vlerësimit dhe trajtimit të sindromave të ndryshme si autizëm, down, prapambetjen mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj.. - Literaturë që ofron informacion dhe shembuj konkret të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara etj.

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al